



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**Nr. 19208 Prot.**

**Shkodër, më 26/09/2024**

**Lënda: Kthim përgjigje**

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.102 prot, datë 24.09.2024, me lëndë “Kërkesë”, drejtuar Bashkisë Shkodër me e.mail në [info@bashkishkoder.gov.al](mailto:info@bashkishkoder.gov.al), ju bëjmë me dije se:

Praktika e dhënies së subvencionit është realizuar deri në vitin 2016, bazuar në akt marrëveshjen e lidhur mes Bashkisë dhe operatorit të transportit urban. Pas këtij viti bashkia ka planifikuar çdo vit në buxhet subvencion për kategoritë nxënës dhe student por që nuk është realizuar për mungesë të akt marrëveshjes, nga pretendimet e operatorit për procedurën e parashtruar nga Bashkia Shkodër.

Për vitin 2025, Bashkia Shkodër në Planin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 ka planifikuar fondin prej 2,000,000 lekë në programin “Transporti Publik”, Pensionistë, studentë apo grupe tjera në nevojë të subvencionuar, artikulli “Subvencione për abonetë e transportit urban”. Ndërkohë jemi në fazën e dëgjësive publike ku sipas dikukutimeve dhe problematikave të dala do të ketë rishikim të planit të buxhetit sipas prioriteteve të cilat reflektohen në Planin e Buxhetit Afatmesëm përfundimtar 2025-2027 që miratohen në Këshillin Bashkiak 2025-2027.

Jemi në kontakt me Ministritë përkatëse, për sqarimin mangësive dhe paqartësive ligjore në lidhje me kompensimin e biletës për kategoritë e veçanta të udhëtarëve, pasi në Ligjin Nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Neni 85, në paragrafin e fundit të të cilit citohet: Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Në Bashkinë Shkodër nuk është ndjekur asnjë praktikë tjetër përveçse asaj që trajtuam më lart. Faleminderit për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Benet BECI**